

**REGULLORJA
PËR
LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARIST**

PRISHTINË, KORRIK 2002.

Në mbështetje të dispozitave të nenit 4.1. të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë , Udhëzimit Administrativ 2001/ 2 dhe 2001/3, nenit 19, dhe 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës të datë 16.03.2001 të Rregullorës për tarifrat dhe ngarkesat Komunale 01.nr. 413-523 prej datë 02. 04. 2002, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2002 miratoi:

R R E G U L L O R E N PËR LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARISTE

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1.

1.1.Emërtimi “ Subjekt afarist “, sipas kësaj Rregulloreje nënkupton secilin subjekt afarist që merret me aktivitete ekonomike të mbështetura në ligj me qëllim përfitimi ,

1.2.Të gjitha aktivitetet afariste ekonomike në Komunën e Prishtinës, duhet të kryhen në vend të caktuar dhe të përshtatshëm..

1.3.Asnjë subjekt afarist sipas kësaj Rregulloreje nuk lejohet të ushtrojë veprimtarinë e vet afariste pa Leje pune nga Drejtorati i Ekonomisë .

Neni 2.

2.1. Subjekti afarist që ushtron afarizmin në Komunën e Prishtinës, duhet të jetë i regjistruar sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2000/8 sipas dispozitave për regjistrimin e përkohshëm të të biznesit në Kosovë dhe në bazë të udhëzimeve tjera administrative të lëshuara nga ana e UNMIK-ut .

2.2. Subjekti që ushtron veprimtari biznesi brenda Komunës së Prishtinës duhet:

(I). Për ndërmarrjen amë dhe për secilën njësi të ketë lejen e punës për ushtrim të biznesit,

(II). Leja e punës ka karakter personal dhe nuk mund të bartet në personin e tretë .

Neni 3.

Subjekti afarist për të marrë lejen e punës, kërkesës duhet t'i bashkangjes:

3.1. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit të ndërmarrjes amë dhe të njësisive të saja në pajtim me Rregullorën e UNMIK-ut 2000/8.

3.2. Lejen e ndërtimit të lokalit afarist apo shëndrrimin në lokal afarist të lëshuar nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimit.

3.2.1. Në zonat e paurbanizuara, lokaleve afariste u ipet leja e punës me kusht që Brenda një viti të siguron lejen e ndërtimit. Nëse edhe pas këtij afati nuk është siguruar leja e ndërtimit, asnjë subjekti afarist për të njejtin lokal afarist nuk do t'i jipet leja e punës.

3.3. Provën me të cilën subjekti afarist e dëshmon pronësin e lokalit afarist ose kontratën për marrje me qira të lokalit afarist të vërtetuar nga Gjykata Kompetente.

3.4. Pëlqimi i dhënë nga Drejtorati i Inspektionit për plotësimin e kushteve minimale teknike – sanitare për lokalin afarist .

3.5. Provë për pagesën e kistit të parë ose të dytë për lëshimin e Licencës sipas Rregullorës për tarifrat dhe ngarkesat Komunale 01. nr. 413-523 të datë 02. 04. 2002.

Neni 4.

Leja e punës për subjektin afarist do të vlejë 1(një) vit nga data e lëshuarjes.

Neni 5.

Ripërtrirja e Lejes për punë të subjektit afarist nëse nuk e ndryshon veprimtarinë apo adresën bëhet :

- 1. Në bazë të kërkesës dhe*
- 2. Pagesës për ripërtrirje të Lejes për punë.*

Kërkesa për ripërtrirje të Lejes për punë duhet të bëhet 15 ditë para skadimit të afatit njëvjeçar.

Neni 6.

Ç'do ndryshim në emërtimin e biznesit apo ndërrimin e adresës së subjektit afarist që ndodh pas dorëzimit të kërkesës për leje pune apo pas marrjes së lejes për punë , subjekti afarist është i obliguar t'a njoftojë Drejtoratin e Ekonomisë në afat prej 7 ditësh, nga dita e ndryshimeve të ndodhura.

Neni 7.

Drejtorati i Ekonomisë është i obliguar që brenda afatit prej 30 ditësh t'i japi përgjigje me shkrim parashtruesit të kërkesë, për kërkesën e tij, poqese kërkesa i refuzohet..

Neni 8.

Subjekti afarist është i obliguar që në lokalin afarist:

8.1 .Të ketë Lejen e punës, e cila duhet të ekspozohet në vend të dukshëm.

8.2. Të vendos në vend të dukshëm orarin e punës i cili do të jetë në pajtim me dispozitat e Rregullorës për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

II. Dispozitat ndërshkuese

Neni 9.

Subjekti afarist do të denohet me denim mandator në shumë prej 100 €, nëse:

9.1. Nuk ka bërë kërkesë për leje pune në afatin e dhënë në këtë Rregullore.

9.2. Nuk bënë kërkesë për ripërtrirjen e kërkesës sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje.

II. Dispozitat përfundimtare

Neni 10.

Leja e punës mund të përdoret vetëm për destinimin e dhënë .

Neni 11.

Leja e punës është e pavlerë:

11.1. Kur subjekti afarist bënë kërkesë për ç'registrim ,

11.2. Nëse pas kalimit të 1(një) viti nga data e lëshuarjes, subjekti afarist nuk bënë kërkesë për ripërtrirjen e lejes për punë,

11.3. Në rast se leja e punës është lëshuar për veprimtarinë e cila nuk është paraparë në nomenklaturën ligjore.

Neni 12.

12.1. Subjekti afarist i cili i plotëson kushtet sipas nenit 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje është i obliguar të bëjë kërkesë për lëshimin e lejes për punë në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të kësaj Rregulloreje .

12.2. Kërkesa për leje pune duhet të jetë e kompletuar e dorëzuar nga pronari apo ndërmjetsuesi i tij (i autorizuari). Nëse themelues të subjektit afarist janë personat në partneritet , atëherë secili prej tyre mund të ushtrojë kërkesë për leje pune.

Neni 13.

Implementimin e kësaj Rregulloreje do t'a bëjë Drejtorati i Ekonomisë dhe Drejtorati i Inspektionit .

Neni 14.

Asgjë nga kushtet e kësaj Rregulloreje Komunale nuk do t'a ndaloj secilin person të goditur nga kushtet e saj për të kërkuar dëmshpërblim nga një trup kompetent ose gjykatë kompetente.

Neni 15.

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga ana e Kuvendit të Komunës .

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
_____NR. _____ DATË _____.

KRYETARI I KUVENDIT
Dr. Salih Gashi